



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Nr. _____ Prot.

Datë 15/05/2009

VENDIM
Nr. 110 , datë 15/05/2009

Për
Një rekomandim mbi projekt-ligjin “Për ofertat publike të titujve”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Z. Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Znj. Servete	GRUDA	Anëtar
Znj. Rezana	KONOMI	Anëtar
Z. Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15/05/2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i Projekt-ligjit “Për ofertat publike të titujve”.

Baza ligjore:

- Neni 24, germa f, dhe neni 69, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Shkresës nr. 3387 Prot., datë 10.04.2009 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

VËREN SE:

Me anë të shkresës nr. 3387 Prot., datë 10.04.2009 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i kërkon Autoritetit të Konkurrencës vlerësimin e tij për projekt-ligjin “Për ofertat publike të titujve”.

Në bazë të nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projekt-aktet normative.

Oferta ka për synim fitimin e kontrollit mbi shoqërinë objekt i ofertës, në këtë mënyrë vetë procesi i blerjes së ofertës kërkon norma rregulluese, krahas atyre që parashikohen në dispozitat për grupimet në nenet nga 206 deri në 212 të Ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Komisioni i Konkurrencës është i mendimit se nëpërmjet këtij Projekt-ligji synohet të bëhet një përcaktim i qartë i rregullave që lidhen me kushtet dhe procedurat për ofertat publike të blerjes së titujve të emetuar nga një shoqëri aksionare, duke kërkuar që ofertat të jenë publike dhe transparente dhe duke monitoruar dhe mbikëqyrur këtë proces nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përqendrimet e ndërmarrjeve që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën një të këtij neni, njoftohen në Autoritetin e Konkurrencës për të marrë autorizim.

Si pasojë e përfitimit të Kontrollit që parashikohet të ndodhë si rezultat i ofertave publike të titujve, mund të krijohet një përqendrim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f, nenin 69, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

Ti rekomandojë METE të shtojë pas pikës 3 të nenit 7 “Dokumenti i ofertës” të projekt-ligjit “Për ofertat publike të titujve”, një dispozitë me përmbajtjen si vijon:

“Kur nga përftimi i kontrollit që parashikohet të ndodhë si rezultat i publikimit të dokumentit të ofertës, mund të krijohet një përqendrim në kuptim të nenit 12, pika 1, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ky përqendrim duhet të njoftohet në Autoritetin e Konkurrencës, për të marrë autorizim, sipas dispozitave përkatëse të këtij ligji.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush PERPALI

Servete GRUDA

Rezana KONOMI

Koço BROKA

Zv/Kryetar

Anëtare

Anëtar

Anëtare

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE